

**Xhulio Zeka**

Xhulio Zeka

**Emanuele Barjamaj**

EMANUELE BARJAMAJ

**AKT THEMELIMI**

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“GHOST GROUP” SH.P.K.**

Sot, më date **18.06.2024**, ne te nënshkruarit :

- **Xhulio Zeka** lindur me **05/01/1995**, ne Bubullime dhe me rezidence ne Tirane, shtetas Shqiptar i identifikuar nepermjet ID me numer **J50105002M**, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar.  
- **Emanuele Barjamaj** lindur me **28/05/1997**, ne Itali dhe banues ne Tirane, shtetas Shqiptar i identifikuar nepermjet leternjofimit me nr.**032852814**, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar ....; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” kam vendosur të themeloje një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar **“GHOST GROUP” SH.P.K.** (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

**Neni 1**

Emri i Shoqërisë është: **“GHOST GROUP” SH.P.K.**

**Neni 2**

(1)Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Tirane, rruga Kristo Luarasi, diga e liqenit, Gener 2, njesia tregtare nr.1 kati 0 kulla C, dyqan me numer pasurie 95/2.

(2)Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: *xhuliozeka66@gmail.com*  
Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

### Neni 3

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Biznesit.

### Neni 4

#### Objekti

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

- b. Import-Eksport i produkteve te kafes , produkteve ushqimore etje . Tregtimi me shumice dhe pakice e produkteve ushqimore dhe produkteve te kafes, Bar-Kafe , Lounge Bar , pasticeri etj.

-Megjithate shoqëria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

### Neni 5

#### Kapitali themeltar

(1)Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000** (njqind mije) Lekë

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Z. Xhulio Zeka** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **52 000** (pesedhjetë mije) Leke që përbën **52 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues **Z. Emanuele Barjamaj** : Zoteruese e 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme prej **48 000** (pesedhjetë mije) Leke qe perben **48%** te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para.



## **Neni 6:**

### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund te behet vetem pasi Asambleja e ortakeve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithë ortaket jane te detyruar qe ta repektojne dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asmblese

## **Neni 7:**

### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërise
- b) shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakeve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve,përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltare janë ligjerisht të trasferueshme me rrugë trashgimnie.

## **Neni 8**

### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë.Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përgjashtimi nga e drejta e votës dhe te tjera modalitete per funksionimin e organit vendimmarres percaktohen ne statutin e shoqërise.

## **Neni 9**

### **Administrimi**

(1)Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.



1. Administratore e shoqerise emerohet znj. **Françeska Zeka** lindur me **04/01/1999** , ne Drenovice dhe banuese ne Tirane , shtetase Shqiptare e identifikuar nepermjet leternjoftimit me nr.**033125387**, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, i zgjedhur per nje periudhe **5** vjecare me te drejte rizgjedhje.

2. Administrator i shoqerise emerohet z.**Emanuele Barjamaj** lindur me **28.05.1997** , ne Itali dhe banues ne Tirane , shtetas shqiptar identifikuar nepermjet leternjoftimit me nr.**032852814** , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar , i zgjedhur per nje periudhe **5** vjecare me te drejte rizgjedhje.

## **Neni 10**

### **Viti financiar-ekspertët**

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pregatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## **Neni 11**

### **Prishja-riorganizimi i shoqërisë**

Modalitetet për prishjen dhe riorganizimin e shoqerise jane te percaktuara ne statutin e shoqerise në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

## **Neni 12**

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale.

## **ORTAKET E SHOQERISE**

**Xhulio Zeka**

Xhulio Zeka



**Emanuele Barjamaj**

EMANUELE BARJAMAJ

